



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 752 Prot.

Tiranë, më datë 21.062022

VENDIM  
Nr. 252, datë 21.06.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 21.06.2022:

VENDOSI:

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për projektin “*Punime restaurimi dhe rijetësimi në banesën e familjes Shella*”, Lagjja Kala, Berat, Monument Kulture i Kategorisë së II-të dhe Brenda Qendrës Historike, me zhvillues Dhoksi Shella;
  - Të unifikohen materialet teknike dhe të plotësohet projekti i restaurimit me gjendjen aktuale dhe me propozimet përkatëse të Monumentit Kategori e II në të gjithë komponentët e tij;
  - Të plotësohet dokumentacioni ligjor me dokumentin që vërteton statusin juridik të pronës;
2. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Rudina ZOTO

